



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të neneve 4, 5, 6, dhe 18 të Ligjit për Ndërtimin nr. 04/L -110, neneve 5, 10.2, 12, 14 dhe 15 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor 2003/14, nenit 11, nenit 12, pika 12.2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 41.2. (c) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **10.09.2013** miraton këtë:

RREGULLORE PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat lidhur me kërkesat për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe lejeve për rrënim të objekteve, si dhe përgjegjësia e organit për lëshimin e tyre, kriteret për ndërtimin, rikonstruimin dhe ndryshimit të destinimit të përdorimit të objekteve ndërtimore ekzistuese, dokumentacioni teknik dhe kontrollimi i tij, leja e përdorimit, inspektimi i zhvillimit të punëve ndërtimore dhe rrënimi i ndërtimeve të kundërligjshme, si dhe përgjegjësia e personave të përfshirë në ndërtime.

Neni 2

2.1. Termet e përdorura në vijim kanë këto kuptime:

2.1.1. "Ndërtim", konsiderohet zhvillimi i punimeve ndërtimore dhe ndërtimore – zejtare, montimi i instalimeve dhe instalimi, përkatësisht montimi i aparateve, impianteve dhe pajisjeve, si dhe rikonstruimi i objekteve ndërtimore etj;

2.1.2. "Ndërtim i objektit", konsiderohet zgjerimi dhe mbindërtimi i objektit ekzistues;

2.1.3. "Ndryshim i objektit", konsiderohet ndryshimi në funksion ose përdorimi i objekteve ekzistuese ndërtimore;

2.1.4. "Rikonstruim" konsiderohet: zhvillimi i punimeve ndërtimore dhe ndërtimore – zejtare në objektin ekzistues në të cilin bëhet sanimi, ndërrimi i instalimeve, impianteve dhe pajisjeve, ndërtimi mbi themele ekzistuese, ndryshimet e objekteve që prekin e anën e jashtme të tij në elemente arkitektonike, në rastet kur bëhet ndërhyrje në konstruksionin e objektit ekzistues, hapje dhe mbyllje dritarësh apo hapje tjera, përkatësisht ndryshimi i kushteve sipas të cilave është lejuar ndërtimi paraprak, si dhe zhvillimi i punimeve ndërtimore për ndryshimin e procesit teknologjik të prodhimit;

2.1.5. Nuk konsiderohet rikonstruim zhvillimi i punimeve rreth mirëmbajtjes së objektit ekzistues me qëllim të përdorimit normal të tij nëse me këto punime nuk ndryshohen kushtet sipas të cilave është lejuar ndërtimi i objektit, si dhe punët rutinore për ruajtjen apo mirëmbajtjen e objekteve apo strukturave ekzistuese;

2.1.6. "Punime ndërtimore", konsiderohen: ndërtimet e reja të çdo lloji mbi dhe nëntokësore, aneksndërtimet, mbindërtimet, impiante të ndryshme; rrugë dhe trotuare;

punime infrastrukturore (ujësjellës, kanalizim, telefoni, elektrifikim etj.), ndërtime mbi themelet ekzistuese, ndryshimet që prekin anën e jashtme arkitektonike të objektit, zhvillimi i punimeve që prekin konstruksionin e objektit ekzistues, hapje dhe mbyllje dritarësh, si dhe hapje tjera, suvatime, rrethimet e përkohshme dhe të përhershme, ndërtime barakash dhe ekspozitash;

2.1.7. "Personi i përfshirë në ndërtim", nënkupton çdo person fizik dhe juridik që merr vendim për investime dhe financon ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve;

2.1.8. "Objektet me banim të përzier" në kuptim të kësaj rregulloreje, kuptohet objekti për banim që ka elemente të formës individuale dhe të atij kolektiv.

Neni 3

Për ndërtimin e objektit investiv vendos investuesi. Kur në ndërtimin dhe financimin e objektit përfshihen shumë persona fizik apo juridik secili prej tyre e ka statusin e investuesit. Zhvillimi i punimeve ndërtimore në rastet kur marrin pjesë shumë investues, mund t'i besohet njërit nga bashkëinvestuesit apo ndonjë personi të autorizuar nga ata.

Neni 4

Kryesi i punëve të objektit ndërtimor duhet të jetë personi (individ) apo ndërmarrja (firma) e specializuar për zhvillimin e punëve ndërtimore apo ndërtimore – zejtare përkatëse dhe e regjistruar në regjistrin e organit kompetent.

Neni 5

Për të gjitha ndërtimet dhe rikonstruksionet, sipas kësaj rregulloreje, duhet të merret leja ndërtimore. Lejen ndërtimore e lëshon Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me aktvendim. Nuk mund të fillojë ndërtimi i objektit pa u siguruar paraprakisht leja ndërtimore.

Neni 6

6.1. Para marrjes së lejes ndërtimore nga neni 5 i kësaj rregulloreje, investuesi duhet të pajiset me dokumentin mbi kushtet urbanistiko – teknike, nëse nuk ka plane rregulluese.

6.2. Kërkesa për dhënien e kushteve urbanistiko – teknike i parashtrohet Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 7

7.1. Përgjashtimisht nga neni 5 dhe 6 i kësaj rregulloreje, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i punimeve që realizohen drejtpërdrejtë para fillimit ose gjatë kohës së fatkeqësive elementare (si vërshimet, zjarret, tërmetet) mund të kryhen edhe pa leje ndërtimi;

7.2. Objektet nga paragrafi paraprak mund të mbeten si objekte të përhershme edhe pas ndërprerjes së rrethanave, të cilat kanë shkaktuar ndërtimin e tyre nëse plotësojnë kushtet e përcaktuara urbanistike – teknike që janë të parapara për ndërtimin e këtyre objekteve me kusht që brenda afatit prej 6 muajsh, pas ndërprerjes së rrethanave të cilat kanë shkaktuar ndërtimin e tyre, mund të legalizohet dhe të merret leja ndërtimore dhe ajo e përdorimit;

7.3. Po që se investuesi brenda afatit të caktuar në paragrafin 7.2 të këtij neni, nuk e merr lejen e ndërtimit, është i obliguar që objektin e këtillë ta rrënojë, përkatësisht ta mënjojë brenda afatit të cilin e cakton organi i administratës komunale, kompetent për punët e ndërtimtarisë. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

II. KUSHTET URBANISTIKO - TEKNIKE

Neni 8

8.1. Kushtet urbanistiko – teknike për ndërtimin e objekteve ndërtimore i cakton Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bazë të PZHU-së, planeve rregulluese urbanistiko – teknike apo akteve tjera të nxjerra nga Kuvendi Komunal, që zëvendësojnë apo plotësojnë këto plane e në kuptim të kësaj rregulloreje pos tjerash paraqesin:

8.1.1. Shënimet mbi lokacionin që jepen në kopjen e bazës gjeodete;

8.1.2. Shënimet mbi mënyrën e dhënies së destinimit të parashikuar të tokës sipas planifikimit dhe llojit, përmbajtjen dhe kapacitetin e objekteve të planifikuara;

8.1.3. Madhësinë, formën dhe pozitën e ngastrës, kuotat e lartësisë, vijën e rregullimit dhe vijën ndërtimore;

8.1.4. Pozitën e objekteve ndaj objekteve fqinje, destinimin e objektit dhe karakteristikat themelore të pamjes së jashtme të objektit me vijën e shënuar të rregullimit tek rruga ose rruga publike (të rrugës së komunikacionit ekzistues ose të planifikuar);

8.1.5. Të dhënat themelore për instalimet, respektivisht për stabilimentet e ujësjellësit, kanalizimit, energjisë elektrike, si dhe theksimi i organizatave komunale dhe organizatave tjera që do të japin kushtet dhe pëlqimet më të afërta për të gjitha instalimet dhe stabilimentet;

8.1.6. Shënimet e objekteve që duhet të rrënohen për shkak të ndërtimit të objektit të ri;

8.1.7. Rregullimin e sipërfaqeve të lira në ngastër;

8.1.8. Kushtet që i kërkon siguria e komunikacionit;

8.1.9. Pjesëmarrja e fqinjëve në shikimin e dokumentacionit dhe informim;

8.1.10. Theksimin e organeve që duhet të japin pëlqimin në dokumentacionin investues – teknik, respektivisht në disa projekte siç janë organet për punët e inspektionit sanitar, shërbimet kundër zjarrit, shërbimet e komunikacionit, të hidroekonomisë dhe të firmave tjera, pëlqimi i të cilave është i domosdoshëm në saje të dispozitave që janë në fuqi;

8.2. Kriteret kryesore urbanistike për ndërtimin e objekteve janë:

8.2.1. Koeficienti i ndërtimit,

8.2.2. Shkalla e shfrytëzimit të ngastrës,

8.2.3. Vija e rregullimit,

8.2.4. Vija ndërtimore,

8.2.5. Gabariti horizontal, vertikal dhe nivelacioni.

8.3. Shkalla e shfrytëzimit të truallit ose ngastrës për ndërtimin e objekteve caktohet si me poshtë:

8.3.1. Për trojet për ndërtim individual për banim dhe afarizëm, sipërfaqja minimale është min 2,5 ari dhe max 5.0 ari me etazhitet P+2,

8.3.2. Për trojet për ndërtimin e objekteve të përziera për banim dhe afarizëm, sipërfaqja minimale është nga 5,0 -10 ari me etazhitet P+4 gjer në P+6,

8.3.3. Për ndërtimin e objekteve për banim kolektiv dhe afarizëm, sipërfaqja minimale është 10 ari me etazhitet P+6 gjer më P+8 dhe duhet të ketë dalje në rrugë në gjerësi frontale min. 20 m';

8.4. Etazhiteti (gabariti vertikal) i objekteve caktohet sipas PZHU-së, planeve rregulluese urbanistike apo akteve tjera të nxjerra nga Kuvendi Komunal e që i zëvendësojnë këto plane.

Neni 9

9.1. Për objektet të cilat ndërtohen afër rrugëve publike, hekurudhës si dhe largpërçuesve, distanca prej këtyre objekteve duhet të jetë në largësinë e paraparë me rregullativën ligjore në fuqi. Dhe për këtë është e domosdoshme marrja e pëlqimit nga ndërmarrjet kompetente për këto çështje;

9.2. Objektet të cilat ndërtohen afër rrugëve të pakategorizuara nuk mund të jenë në distancë më të vogël se 5 m nga skaji i jashtëm i brezit të rrugës.

Neni 10

10.1. Vija rregullative siguron korridorin për vendosjen e rrjetit primar dhe sekondar të infrastrukturës (ujësjellësit, kanalizimit, PTK-së, ngrohjes etj.) së qytetit dhe vendbanimeve tjera, përveç nëse me planet urbanistike parashihet ndryshe;

10.2. Në zonat e reja ndërtimore me planet urbanistike përcaktohet korridori për vendosjen e rrjetit të infrastrukturës në mes të vijave rregullative në zonat e interesit të përgjithshëm (rrugët publike), si dhe jashtë këtyre zonave (rrjetit të ujësjellësit, largpërçuesit, ngrohjes e të ngjashme);

10.3. Në hapësirat në mes vijave rregullative sigurohet edhe zgjidhja për gjelbërimin publik në koordinim të domosdoshëm me nivelin e planifikimit të rrjetit të infrastrukturës;

10.4. Distanca në mes të ndërtesave në raport me rrugën duhet të përforcojë rrugët me përparësi për këmbësorë (shëtitore) dhe duhet të jetë sa lartësia e ndërtesës (H) pra raporti 1:1;

10.5. Objekti shumëbanesor në ngastër mund të vendoset vetëm nëse i plotëson këto kushte:

10.5.1. Distanca në mes të ndërtesës me hapje dhe vijës së parcelës duhet të jetë minimum 0.5 H (lartësia e ndërtesës) ose mund të ndryshojë me marrëveshje me fqinjë,

10.5.2. Distanca në mes të ndërtesës pa hapje ose me hapje për ajrosje dhe vijës së parcelës duhet të jetë minimumi 0.25 H ose mund të ndryshojë me marrëveshje me fqinjë,

10.5.3. Pjesa ballore duhet të respektojë vijën e përcaktuar ndërtimore.

Neni 11

11.1. Vija ndërtimore paraqet vijën e cila përcaktohet me plane rregulluese urbanistike dhe leje urbanistike. Në dokumentin e theksuar, vija ndërtimore caktohet në raport me vijën rregulluese. Vija ndërtimore përputhet me vijën rregulluese apo në distancën e paraparë nga vija rregulluese dhe atë në parcelën ndërtimore;

11.2. Nuk lejohet dalja e shtyllave mbajtëse e objektit apo objektit nëntokësor jashtë vijës ndërtimore.

Neni 12

12.1. Përjashtimisht nga neni 11 i kësaj rregulloreje, objektet e ndërtuara nën tokë (pjesë të objektit, bodrume, strehimore, garazhe etj.), sipas nevojave mund të përcaktohen me leje urbanistike edhe në distancën në mes të vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore, si dhe në pjesët tjera jashtë gabaritit të objektit, nëse me këtë nuk rrezikohet rrjeti i ndërtuar dhe ai i planifikuar i infrastrukturës;

12.2. Për rastet nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet vija ndërtimore nëntokësore përmes lejes urbanistike.

Neni 13

13.1. Distanca në mes të vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore për objektet ndërtimore individuale, përcaktohet me plane rregulluese. Nëse kjo distancë nuk është caktuar me plan, atëherë varësisht nga tipi i objektit kjo distancë është prej 0 deri në 300 cm;

13.2. Për objektet individuale për banim të të gjitha llojeve ku planifikohet garazhimi i automjeteve qoftë nëntokësore apo në etazhin përdhese, distanca minimale në mes të vijës rregulluese dhe asaj ndërtimore është 500 cm;

13.3. Për objektet individuale për banim, të cilat kanë qasje të drejtpërdrejt apo indirekt me rrugët publike, distanca në mes të vijës rregulluese caktohet me leje urbanistike e që nuk mund të jetë më e vogël se 400 cm.

Neni 14

14.1. Distanca në mes të objekteve individuale për banim përcaktohet me plane rregulluese. Nëse kjo distancë nuk është përcaktuar me plan rregullues, varësisht nga tipi, lloji, pozita dhe vija rregulluese ndërtimore, kjo distancë është prej 0 deri në 400 cm;

14.2. Në rast kur distanca në mes objekteve individuale për banim është më e vogël se 300 cm, nuk mund të ketë pjesë të hapura në anët nga objektet fqinjë përpos dritareve të shkallëve dhe banjave;

14.3. Në lagjet e reja urbanistike, largësia e paraparë me këtë dispozitë mund të jetë edhe më e madhe.

Neni 15

Distanca e gabaritit bazë (pa konzollë) e objekteve individuale për banim nga vija e parcelës ndërtimore fqinje, përcaktohet me planet detale apo rregullative nëse kjo distancë nuk është përcaktuar me këto plane, varësisht nga tipi i objektit kjo distancë është prej 150 cm deri në 400 cm.

Neni 16

16.1. Elementet ndërtimore të objekteve (konzollat, strehët e hyrjeve me dhe pa shtylla etj.) në nivel të katit mund të kalojnë vijën ndërtimore duke llogaritur sipas gabaritit bazë të objektit, gjegjësisht vijës ndërtimore më së shumti 120 cm;

16.2. Përjashtim nga paragrafi 1 e këtij neni për objektet ekzistuese apo të reja, lartësia e të cilave nga terreni (trotuari) deri te elementi ndërtimor (konzolla) është më e vogël se 250 cm, nuk lejohet dalja me element ndërtimor (konzollë).

Neni 17

Kuota nivelizuese e përdheses për objektet individuale për banim me apo lokal afarist, është prej kuotës së trotuarit e deri më së shumti 120 cm.

Neni 18

18.1. Distanca më e vogël e projeksionit horizontal e strehës nga parcela ndërtimore fqinje duhet të jetë 90 cm;

18.2. Te objektet ekzistuese të cilat rikonstruohen e për të cilat nuk mund të sigurohet distanca nga alineja 1 e këtij neni, nuk lejohet vendosja e strehës.

Neni 19

19.1. Rrethimi i parcelave ndërtimore rregullohet me plane rregulluese. Në rastet kur me këto plane nuk është e rregulluar apo këto plane mungojnë, ndërsa traditat lokale diktojnë, parcelat mund të rrethohen me mur deri në lartësinë prej 90 cm nga niveli i terrenit (trotuarit) apo me rrethojë transparente (të tejdukshme), në lartësi gjer më 140 cm. Rrethoja nga alineja 1 e këtij neni duhet të vendoset në vijën rregulluese në brendësi të parcelës;

19.2. Rrethojat nga parcelat fqinje mund të vendosen edhe në aksin e kufirit të parcelave fqinje, nëse për këtë jepet pëlqimi nga fqinjët;

19.3. Rrethojat e parcelave që kufizohen me udhëkryqe nuk mund të jenë më të larta se 90 cm, për shkak të sigurimit të shikimit vizual të udhë kryqit.

Neni 20

Sipërfaqja e lirë e parcelës e paraparë me nenin 8, paragrafi 3 i kësaj rregulloreje mund të betonohet apo pllakëzohet më së shumti 30 %.

Neni 21

Lartësia e muratimit te kati i nënkuilmit të objektit për banim është 180 cm, duke u llogaritur nga kuota e dyshemesë së nënkuilmit e deri në pikën e takimit me pjerrtësinë e kulmit.

Neni 22

22.1. Në një parcelë mund të ndërtohet vetëm një objekt individual për banim me apo pa lokal afarist;

22.2. Përfundimisht nga alineja 1 e këtij neni në ngastër mund të ndërtohen objektet ndihmëse, nëse me plan rregullues nuk është paraparë ndryshe apo në ato vende ku lejojnë kushtet mund të ndërtohen objekte të përkohshme siç parashihet me dispozitat e kësaj rregulloreje (kreu IX).

Neni 23

23.1. Distanca e vijës ndërtimore nga vija rregullative për objektet individuale për banim në fshatra caktohet me plane rregulluese;

23.2. Nëse me këto plane nuk është caktuar, atëherë kjo distancë duhet të jetë 300 – 500 cm. Distanca në mes objekteve individuale për banim në fshatra rregullohet me plane rregulluese;

23.3. Nëse kjo distancë nuk është rregulluar me këto plane, atëherë kjo distancë është prej 500 – 1000 cm, varësisht nga numri i kateve të objektit;

23.4. Distanca e objektit individual për banim nga objektet ekonomike (shtallat, kotecet etj) apo objektet tjera ndihmëse (fushore, depozitë e plehrave etj) është prej 1500 – 2500 cm. Me kushtet urbanistike – teknike caktohet pozita e objekteve ekonomike dhe ndihmëse në raport me vijën ndërtimore.

Neni 24

Vendosja e objekteve ekonomike dhe ndihmëse në fshatra nuk mund të jetë në distancë më të vogël se 150 cm nga fqinja ku është ndërtuar objekti ekonomik.

Neni 25

Koeficienti i ndërtimit të parcelës në fshat rregullohet me plane rregulluese nëse me këto plane nuk është rregulluar, atëherë ky koeficient është 30 % për pjesën e parcelës të dedikuar për banim, ndërsa 60 % për parcelën e dedikuar për objekte ekonomike.

Neni 26

26.1. Parcelat në vendbanimet e fshatrave mund të rrethohen në anën nga rruga publike, me mure në lartësi prej 120 cm apo me rrethojë transparente (të tejdukshme) në lartësi prej 180 cm;

26.2. Rrethojat nga parcelat fqinje mund të vendosen edhe në aksin e kufirit të parcelave fqinje nëse për këtë jepet pëlqimi nga fqinjët;

26.3. Rrethojat nga alineja 1 e këtij neni vendosen në vijën rregullative në brendësi të parcelës;

26.4. Parcela në vendbanimet e fshatrave mund të ndahet në një pjesë funksionale dhe atë për banim, pjesën ekonomike dhe ndihmëse.

Neni 27

Kriteret, përkatësisht kushtet urbanistiko – teknike për ndërtimin e objekteve me banim të përzier rregullohen me PZHU, si dhe me plane rregulluese.

Neni 28

28.1. Kriteret e ndërtimit të objekteve për banim kolektiv si: caktimi i vijës ndërtimore, gabariti, indeksi i ndërrueshmërisë, numri i kateve, distanca në mes të objekteve, si dhe kriteret tjera për ndërtueshmërinë e këtyre objekteve rregullohen me plane detaje apo rregullative;

28.2. Kriteret për ndërtimin e strehimoreve rregullohen me plane rregulluese, si dhe me rregullativën tjetër ligjore që plotësojnë këto plane.

Neni 29

Kriteret për ndërtimin e objekteve ndërtimore (ekonomike, industriale, hoteliere, rekreativo – sportive, infrastrukturë, objektet me interes të përgjithshëm shoqëror) rregullohen me plane rregulluese dhe si bazë e destinimit të këtyre objekteve në çdo rast duhet të jetë PZHU-ja.

III. DOKUMENTACIONI PËR KUSHTET URBANISTIKO – TEKNIKE

Neni 30

30.1. Çdo person fizik apo juridik që dëshiron të kryejë punime ndërtimore konform kësaj rregulloreje, duhet të pajiset me dokumentin për caktimin e kushteve urbanistiko – teknike, përveç rasteve ku ka plane rregulluese;

30.2. Kërkesa për caktimin e kushteve urbanistiko – teknike i parashtrohet Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;

30.3. Kërkesës nga alineja 30.2 e këtij neni, kërkuesi duhet t'ia bashkëngjisë këtë dokumentacion:

30.3.1. Kopjen e planit dhe fletën poseduese,

30.3.2. Fotokopjen e dokumentit identifikues të kërkuesit, si dhe

30.3.3. Projektin ideor apo skicat e objektit për të cilin kërkohen kushtet urbanistiko-teknike.

Neni 31

31.1. Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit miraton apo refuzon dhënien e kushteve urbanistiko – teknike brenda afatit prej 15 ditësh për objektet e kategorisë I dhe 30 ditë për objekte të kategorisë së II. Në rastet kur miratohet kërkesa për caktimin e kushteve urbanistiko – teknike, duhet të caktohen punët përgatitore, kushtet e ndërtimit të objektit për kyçje në infrastrukturë;

31.2. Kushtet urbanistiko – teknike nga alineja 30.2 e këtij neni caktohen në formë tekstuale dhe grafike;

31.3. Në rastet kur kërkesa për caktimin e kushteve urbanistiko – teknike refuzohet, në aktvendim jepet arsyetimi për refuzimin e kërkesës;

31.4. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, pala e pakënaqur mund t'i paraqesë ankesë organit kompetent (MMPH) brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të aktvendimit.

Neni 32

32.1. Kushtet urbanistiko – teknike për ndërtimin e objektit i jepen parashtruesit të kërkesës apo personit të autorizuar nga ai;

32.2. Kushtet urbanistiko – teknike të caktuara vlejnë 1 vit nga data e lëshimit;

32.3. Nëse investitori nuk fillon ndërtimin brenda afatit të paraparë nga paragrafi 2 e këtij neni, kërkesa për caktimin e kushteve urbanistiko – teknike duhet të përsëritet;

32.4. Nëse brenda afatit të paraparë me paragrafin 2 të këtij neni bëhet transferimi i të drejtës në tokën për të cilën janë caktuar për ndërtim, transferohen edhe kushtet urbanistiko – teknike.

IV. LEJA NDËRTIMORE

Neni 33

- 33.1.** Çdo person fizik apo juridik i pajisur me kushte urbanistiko – teknike mund të paraqesë kërkesë për dhënien e lejes ndërtimore;
- 33.2.** Leja ndërtimore i jepet kërkuarit apo personit të autorizuar nga kërkuari;
- 33.3.** Leja ndërtimore vlen 1 (një) vit duke e llogaritur nga data e lëshimit të saj me mundësi të vazhdimit edhe për 1 (një) vit;
- 33.4.** Vazhdimi i lejes ndërtimore bëhet me kërkesë të palës. Kërkesa për vazhdimin e lejes duhet t'i paraqitet organit që e ka lëshuar lejen ndërtimore para skadimit të afatit të caktuar;
- 33.5.** Kërkesës për leje ndërtimore duhet t'i bashkëngjitet përpos dokumentacionit të paraparë me paragrafin 3 të nenit 30 të kësaj rregulloreje edhe kushtet urbanistiko – teknike dhe dokumentacioni tjetër teknik në tri kopje të vërtetuara, si dhe për kyçje në infrastrukturë.
- 33.6.** Për kërkesat e parashtruara për mbindërtimin e objekteve ekzistuese, si pjesë e dokumentacionit teknik është e domosdoshme të bashkëngjiten edhe vërtetimet nga ndërmarrjet apo instituti profesional, lidhur me ndikimin e mbindërtimit nga aspekti i paraparë me paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj rregulloreje;
- 33.7.** Kërkesa për leje ndërtimore i parashtrohet Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit. Shqyrtimin e kërkesës për leje ndërtimore, drejtoria duhet ta bëjë brenda 15 ditësh duke e llogaritur nga dita e pranimit të kërkesës;
- 33.8.** Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit – pas shqyrtimit të kërkesës, konstatimit të gjendjes faktike (mbi ndryshimet eventuale në terren) dhe dhënies apo mosdhënies së pëlqimit të dokumentacionit teknik merr vendim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për leje ndërtimore.
- 33.9.** Nëse dokumentacioni teknik nuk është në harmoni me kushtet urbanistiko – teknike të caktuara me lejen urbanistike (dokumentin mbi kushtet urbanistike), si dhe me standardet dhe normativat e aplikueshme, dokumentacioni teknik i kthehet investitorit për plotësim dhe harmonizim me kushtet urbanistiko – teknike të caktuara;
- 33.10.** Afati për plotësimin apo harmonizimin e dokumentacionit teknik nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë;
- 33.11.** Pas dhënies së pëlqimit në dokumentacion teknik, bëhet llogaritja e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për neto sipërfaqen e objektit, sipas projektit të prezantuar në lartësinë e paraparë me rregullativën në fuqi;
- 33.12.** Nuk mund të jepet në dorëzim leja ndërtimore pa provën mbi pagesën e kompensimit nga paragrafi 11 i këtij neni.

V. DOKUMENTACIONI TEKNIK

Neni 34

- 34.1.** Varësisht nga lloji, tipi dhe destinimi i objektit, dokumentacioni teknik për ndërtimin dhe rikonstruimin e objekteve ndërtimore punohet si projekt ideor, projekt kryesor, projekt zbatues dhe projekt i objektit të zbatuar;
- 34.2.** Si pjesë e dokumentacionit teknik për objektet e mëdha ndërtimore është edhe projekti ideor i punishtes;
- 34.3.** Projekti ideor hartohet për nevojat e përcaktimit të objektit;
- 34.4.** Projekti kryesor hartohet për nevojat e ndërtimit dhe pajisjes me leje ndërtimore;
- 34.5.** Projekti zbatues hartohet për nevojat e kryerjes së punimeve nëse projekti kryesor nuk i përmban detajet e nevojshme për ndërtimin e objektit;
- 34.6.** Projekti i punishtes hartohet me qëllim të organizimit të punishtes, kyçjes së përkohshme në infrastrukturë të ngjashme;
- 34.7.** Projekti i objektit të zbatuar hartohet për nevojat e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së objektit, varësisht nga lloji apo tipi i objektit ndërtimor, ndërkaq kërkesës duhet t'i

bashkëngjitet edhe projekti i organizimit të punishtes nëse këtë e kërkon organi kompetent për leje ndërtimore.

Neni 35

35.1. Projekti kryesor nga paragrafi 35.3 i neni 35 të kësaj rregulloreje, duhet të përmbajë:

35.1.1. projektin arkitektonik,

35.1.2. projektet e instalimeve (ujësjellësit, kanalizimit, elektrikës, PTK-së dhe ngrohjes),

35.1.3. projektin e mbrojtjes kundër zjarrit;

35.2. Dokumentacioni teknik për ndërtimin e objekteve në kuadër të të cilave parashikohen me projekt strehimoret me dy destinime ose instalime dhe impiante të destinuara për rast lufte, duhet plotësuar kushte të posaçme me të cilat përcaktohen normativat teknike dhe kushtet tjera të ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes;

35.3. Për mbindërtimin e objekteve, projektin kryesor duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni i cili duhet të përmbajë analizën e kushteve të mbindërtimit me të cilën vërtetohet se:

35.3.1. Mbindërtimi deri në lartësinë e paraparë nuk do të ndikojë në stabilitetin e objektit ekzistues e as në objektet fqinje;

35.1.2. Mbindërtimi nuk do të ndikojë në shfrytëzimin normal të objektit ekzistues dhe

35.1.3. Objekti ekzistues pas përfundimit të mbindërtimit si tërësi i plotëson kushtet e stabilitetit, sigurisë dhe kushtet bashkëkohore të shfrytëzimit të atij objekti.

Neni 36

36.1. Harmonizimin e dokumentacionit teknik me kushtet urbanistiko – teknike e vërteton Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;

36.2. Nuk mund të bëhet ndryshimi në projektin kryesor pa pëlqimin e projektantit;

36.3. Nëse para apo gjatë zhvillimit të punimeve investitori vendos të ndryshojë pjesë të projektit kryesor, për këto ndryshime duhet të merret pëlqim nga hartuesi i projektit dhe nga organi përgjegjës nga paragrafi 36.1 i këtij neni;

36.4. Për ndryshimet në pjesët e projektit kryesor, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit mund të aprovojë apo refuzojë dhënien e pëlqimit.

Neni 37

37.1. Hartimin e dokumentacionit teknik mund ta bëjë vetëm ndërmarrja apo firma projektuese profesionale e regjistruar në regjistrin e organit shtetëror përkatës për kryerjen e këtyre punëve;

37.2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, pjesën e dokumentacionit teknik mund ta hartojë edhe investitori kur ndërton objektin ndërtimor për nevojat e veta e që posedon kualifikimin superior nga lëmi përkatës.

VI. KONTROLLIMI I DOKUMENTACIONIT TEKNIK

Neni 38

38.1. Deri në themelimin e një ndërmarrjeje të specializuar në nivel të Kosovës, kontrollimin e dokumentacionit teknik e bënë ndërmarrja apo firma projektuese profesionale e cila nuk ka marrë pjesë në hartimin e dokumentacionit teknik;

38.2. Ndërmarrja apo firma që bënë kontrollimin teknik mban tërë përgjegjësinë për dokumentacionin teknik, lidhur me atë se ky dokumentacion është i hartuar në bazë të rregullativës ligjore në fuqi, standardeve të normativave teknike e të normave të cilësisë e të cilat aplikohen në ndërtimin e llojit përkatës të objekteve dhe që kanë të bëjnë me stabilitetin e objektit dhe me ndërtimin e objekteve në rajonet sizmike, zgjidhjet teknike dhe

teknologjike që i përmban projekti me saktësinë e paramasës dhe paralogarisë, si dhe me specifikimin e punimeve me vlerësim real të tyre;

38.3. Ndërmarrja apo firma që ka bërë kontrollimin e dokumentacionit teknik është e obliguar që parregullsitë e konstatuara gjatë kontrollimit të dokumentacionit teknik t'i evidentojë dhe t'i konstatojë në vlerësimin përfundimtar, si dhe ta njoftojë investitorin për parregullsitë në projekt.

VII. FILLIMI I ZHVILLIMIT TË PUNËVE NDËRTIMORE

Neni 39

39.1. Çdo person fizik apo juridik i pajisur me leje ndërtimore, para fillimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore duhet t'i paraqesë kërkesë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektive, për caktimin e vijës ndërtimore dhe shënimin e gabaritit horizontal të bazës së objektit (themelit);

39.2. Në mënyrë që organi nga paragrafi 39.1 i këtij neni të bëjë shënimin e vijës ndërtimore të objektit, investitori duhet të bëjë pastrimin e pjesës së ngastrës ku bëhet shënimi.

Neni 40

40.1. Investitori është i obliguar që pas çdo faze të ndërtimit të ketë protokolle të nënshkruara nga ana e inspeksionit të ndërtimit, sipas nenit 31 të Ligjit mbi ndërtimin;

40.2. Organi nga paragrafi 40.1 i këtij neni, është i obliguar që brenda afatit sa më të shkurtër e më së shumti brenda 5 (pesë) ditësh të punës nga dita e pranimit të kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike dhe të lëshojë vërtetimin e kërkuar.

VIII. KRYERËSI I PUNËVE

Neni 41

41.1. Ndërtimin e objekteve ndërtimore, përkatësisht zhvillimin e punëve ndërtimore, mund ta bëjë vetëm ndërmarrja, firma apo punëtorja e specializuar për llojin përkatës të punëve e regjistruar në regjistrin e organit shtetëror përkatës.

41.2. Kryerësi i punëve është i obliguar që:

41.2.1. zhvillimin e punëve ta bëjë ekskluzivisht sipas dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është lëshuar leja ndërtimore,

41.2.2. të organizojë punishten në atë mënyrë me të cilën do të sigurohet qasja e lokacionit me rrugët teknike,

41.2.3. të bëjë sigurimin e qarkullimit të komunikacionit pa pengesa,

41.2.4. të bëjë sigurimin e rrethojës gjatë kohës së zgjatjes së zhvillimit të punimeve,

41.2.5. të bëjë sigurimin e objektit për personat brenda dhe jashtë punishtes, si dhe

41.2.6. të udhëheqë ditarin e ndërtimit dhe librin e inspektimit të punëve ndërtimore;

41.3. Kryerësit të punëve i ndalohe zhvillimi i punimeve në objektet për të cilat investitori nuk është pajisur me leje ndërtimore.

IX. MBIKËQYRJA PROFESIONALE E NDËRTIMIT TË OBJEKTIT

Neni 42

42.1. Gjatë ndërtimit të objektit investuesi ka për detyrë të sigurojë mbikëqyrjen profesionale.

42.2. Mbikëqyrja profesionale nga alineja 42.1 e këtij neni nënkupton:

42.2.1. verifikimin e cilësisë së zhvillimit të punimeve dhe aplikimin e dispozitave,

42.2.2. standardeve,

42.2.3. normativave teknike,

42.2.4. kontrollin e materialit që përdoret në ndërtim dhe atestet e tyre,

- 42.2.5. kontrollin e ndërtimit të objektit sipas dokumentacionit teknik,
42.2.6. saktësinë e shënimit të objektit dhe
42.2.7. afatet e kontraktuara për zhvillimin e punimeve dhe aplikimin e ligjit dhe rregullativën tjetër ligjore nga lëmi i ndërtimit;
42.3. Secila fazë e ndërtimit është pjesë përbërëse e kërkesave të lejes ndërtimore dhe inspektimi bëhet pas përfundimit të secilës fazë;
42.4. Inspektori verifikon përputhjen e punëve të përfunduara me dokumentacionin ndërtimor dhe në fund nënshkruhet protokollin nga poseduesi i lejes, kontraktuesi dhe inspektori.

Neni 43

- 43.1. Investuesi, mbikëqyrjen profesionale të ndërtimit mund ta bëjë ose t'ia besojë ndërmarrjes profesionale të regjistruar në regjistrin e organit përkatës për kryerjen e punëve të tilla;
43.2. Mbikëqyrjen profesionale mund t'ia besojë edhe individit me përgatitje profesionale përkatëse;
43.3. Investuesi, besimin e mbikëqyrjes profesionale në kuptim të këtij neni e bën me kontratë.

X. CERTIFIKATA E PËRDORIMIT

Neni 44

- 44.1. Çdo person fizik apo juridik i përfshirë në ndërtim në kuptim të kësaj rregulloreje, pas përfundimit të ndërtimit është i obliguar të pajiset me Certifikatën e Përdorimit;
44.2. Certifikatën e Përdorimit e lëshon organi që e ka lëshuar lejen ndërtimore;
44.3. Kërkesës për lëshimin e Certifikatës për Përdorim i bashkëngjiten:
44.3.1. protokollet që verifikojnë përfundimin e të gjitha fazave të ndërtimit të përcaktuara për objektin në dokumentacionin ndërtimor,
44.3.2. evidenca e rezultateve pozitive të testimit të kryer siç është parashikuar në kod të ndërtimit,
44.3.3. nëse kushtet e parapara më ligj janë përmbushur, certifikata lëshohet brenda 15 ditësh për kategorinë e parë dhe 30 ditësh për kategorinë e II-të, prej ditës së pranimit të dokumentacionit,
44.4. Certifikata e Përdorimit mund të jepet edhe për një pjesë të objektit i cili paraqet një tërësi tekniko – teknologjike dhe si i tillë mund të përdoret.

Neni 45

- 45.1. Në territoret (hapësirat) e përfshira me planet urbanistike në pronësi individuale, derisa nuk bëhet qasja e rregullimit dhe ndërtimit të hapësirës sipas këtyre planeve, mund të përcaktohen kushtet e përkohshme për rregullimin e hapësirës dhe të lëshohen lejet e përkohshme ndërtimore për ngritjen dhe vendosjen e objekteve të përkohshme me destinim të veçantë dhe atë:
45.1.1. në ngastrat e pandërtuara ndërtimore,
45.1.2. ndërtimi i përkohshëm i lokaleve afariste për nevojat e ekonomisë (depot, garazhet e të ngjashme),
45.1.3. ndërtimi i objekteve të vogla që shërbejnë si lokale afariste me sipërfaqe më së shumti 25 m²,
45.1.4. aneks-ndërtimi i objektit ndërtimor, me qëllim të përmasimit të kushteve të banimit dhe në atë sipërfaqe më së shumti prej 40 m²;
45.2. Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj dispozite, janë objektet e ndërtuara me etazhitet " P + 0 " dhe konstruksion të tavanit nga materiali i lehtë ndërtimor (pa pllakë nga betoni i armiruar).

Neni 46

Rregullat, procedurat dhe kriteret për ndërtimin e objekteve të përkohshme dhe lëshimin e lejeve për ndërtimin e këtyre objekteve, në tokën ndërtimore, në të cilën komuna e ka të drejtën e disponimit, rregullohet me rregullore të veçantë të komunës.

X. NDRYSHIMI I DESTINIMIT TË PËRDORIMIT TË OBJEKTIT NDËRTIMOR EKZISTUES

Neni 47

47.1. Çdo person fizik apo juridik që dëshiron të zhvillojë punime ndërtimore me qëllim të ndërrimit të destinimit të përdorimit të objektit ekzistues ndërtimor, është i obliguar të pajiset me leje përkatëse për shndërrim;

47.2. Lejen për shndërrimin nga paragrafi 47.1 i këtij neni e lëshon Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit sipas rregullave, procedurave dhe kriterëve të parapara me këtë rregullore;

47.3. Organi nga paragrafi 47.2 i këtij neni, gjatë caktimit të kriterëve urbanistiko – teknike, përpos kriterëve të parapara me këtë rregullore, varësisht nga specifiket e zhvillimeve të punimeve mund të caktojë edhe kriterë shtesë lidhur me realizimin e ndryshimit të destinimit për përdorim.

XI. INSPEKTIMI I ZHVILLIMIT TË PUNËVE NDËRTIMORE

Neni 48

48.1. Inspektimin e zhvillimit të punëve ndërtimore në të gjitha fazat e ndërtimit të objektit ndërtimor e bën organi komunal për punët e inspektionit ndërtimor;

48.2. Gjatë inspektimit të zhvillimit të punëve ndërtimore konstatohet se personi i përfshirë në ndërtim zhvillon, përkatësisht nuk i zhvillon punimet ndërtimore sipas lejes ndërtimore, kushteve urbanistiko – teknike dhe dokumentacionit teknik;

48.3. Nëse gjatë mbikëqyrjes inspektuese konstatohet se personi i përfshirë në ndërtim, nuk i është përmbajtur kushteve urbanistiko – teknike të caktuara me leje urbanistike dhe leje ndërtimore, si dhe dokumentacionit teknik, inspektori i ndërtimtarisë, lëshimet e konstatuara do t'i evidentojë në procesverbal me urdhëresë për ndërprerjen e zhvillimit të punimeve;

48.4. Një kopje e procesverbalit mbi gjendjen e konstatuar i dërgohet organit komunal që ka lëshuar lejen ndërtimore;

48.5. Nëse organi që ka lëshuar lejen ndërtimore pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe sigurimit të provave plotësuese, konstaton se investitori nuk i është përmbajtur kushteve urbanistiko – teknike të caktuara me lejen urbanistike, lejen ndërtimore dhe dokumentacionin tjetër teknik, revokon lejen ndërtimore dhe informon organin përgjegjës për fillimin e procedurës së paraparë për marrjen e masave ndaj personave të përfshirë në ndërtimin e objekteve pa leje ndërtimore;

48.6. Çdo mosbashkëpunim apo pengim i inspektimit të zhvillimit të punëve ndërtimore nga investuesi, është i ndaluar dhe i sanksionuar sipas rregullativës ligjore në fuqi.

Neni 49

Organi kompetent për punët e inspektionit ndërtimor, në rastin e konstatimit të zhvillimit të punimeve ndërtimore pa leje ndërtimore me procesverbal konstaton gjendjen, urdhëron ndërprerjen e zhvillimit të punimeve dhe fillon procedurën për shqiptimin e gjobave sipas rregullativave ligjore në fuqi.

Neni 50

Mënyra më e përafërt e inspektimit për disiplinën e zhvillimit të punëve ndërtimore, rregullohet me rregullore të veçantë të komunës.

XII. NDËRTIMET ILEGALE DHE ZËNIA ARBITRARE E TRUALLIT

Neni 51

Çdo zënie arbitrare e truallit me qëllim ndërtimi, përveç dënimit me gjobë, shoqërohet edhe me detyrimin e prishjes së menjëhershme të objektit dhe kthimin e truallit në gjendje të mëparshme me shpenzimin e zënësit të truallit.

Neni 52

- 52.1. Ndërtimet e bëra pa leje ndërtimore janë të kundërligjshme;
- 52.2. Ndalohet evidentimi në regjistrin e kadastrit të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimore, si dhe hipotekimi i tyre;
- 52.3. Ndalohet evidentimi i biznesit në objektet e ndërtuara pa leje ndërtimore;
- 52.4. Për efektet e zbatimit të planeve urbanistike, komuna nuk do t'u bëjë kurrfarë kompensimi pronarëve të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi.

XIII. LEJA PËR RRËNIMIN E OBJEKTIT

Neni 53

- 53.1. Çdo person fizik apo juridik që dëshiron të rrënojë objektin ekzistues ndërtimor, duhet të pajiset me leje përkatëse për rrënim;
- 53.2. Kërkesa për lëshimin e lejes për rrënimin e objektit ekzistues, i paraqitet Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- 53.3. Kërkesës për lëshimin e lejes për prishje, përpos provës mbi të drejtën e pronësisë apo të drejtën e disponimit në atë objekt, duhet t'i bashkëngjitet edhe pëlqimi nga institucionet për mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe historike;
- 53.4. Organi përgjegjës nga paragrafi 53.2 i këtij neni, është i obliguar që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, me aktvendim të aprovojë apo refuzojë kërkesën për rrënimin e objektit.

Neni 54

- 54.1. Përjashtimisht nga neni 53 i kësaj rregulloreje, objektet që paraqesin rrezik për shembje dhe pasojat për jetën, shëndetin e njerëzve dhe për pasurinë e personave të tretë, organi kompetent për punët e inspektimit të ndërtimtarisë, sipas detyrës zyrtare e në bazë të raporteve teknike të ekspertëve, cakton afatin e rikonstruktimit, përkatësisht evitimin e pasojave të objektit;
- 54.2. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë;
- 54.3. Nëse pronari apo shfrytëzuesi i objektit për të cilën është urdhëruar rikonstruimi apo adaptimi brenda afatit të caktuar me paragrafin 54.2 të këtij neni, nuk zhvillon punime për rikonstruimin apo adaptimin, organi kompetent për punët e inspektionit të ndërtimtarisë do të bëjë rrënimin e atij objekti me shpenzimet e pronarit të atij objekti.

XIV. RRËNIMI I OBJEKTEVE TË NDËRTUARA NË KUNDËRSHTIM ME DISPOZITAT E KËSAJ RREGULLOREJE

Neni 55

- 55.1. Çdo ndërtim i objekteve ndërtimore i ndërtuar në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje do të rrënohet;
- 55.2. Urdhëresën për rrënim të objektit ndërtimor nga paragrafi 55.1 i këtij neni e lëshon Drejtoria për Inspektim;
- 55.3. Urdhëresa për rrënim duhet t'i dorëzohet personit të angazhuar në ndërtim me udhëzim juridik, për të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditësh;
- 55.4. Ankesa nga alineja 55.4 e këtij neni i paraqitet MMPH-së si shkallë e dytë;
- 55.5. Për ankesën kundër urdhëresës për rrënim, duhet të vendoset brenda 30 ditësh duke llogaritur nga dita e dorëzimit të ankesës;
- 55.6. Me vendim të organit nga alineja 56.4 e këtij neni, urdhëresa për rrënim mund të vërtetohet apo anulohet;
- 55.7. Me urdhëresën e vërtetuar për rrënim, organi kompetent i komunës e bën të ditur pronarin për rrënimin e objektit të ndërtuar në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje;
- 55.8. Çdo person i përfshirë në ndërtimin e objekteve në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, për të cilën është urdhëruar rrënimi apo është vërtetuar urdhëresa për rrënim, përpos rrënimin pa detyrime të kompensimit, do t'i paguajë edhe gjobat e parapara me rregullativën ligjore në fuqi.

Neni 56

Përjashtimisht nga procedurat e parapara me nenin 55 të kësaj rregulloreje, nëse objekti i ndërtuar në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve apo të rrethit, organi kompetent i komunës rrënimin mund ta bëjë sipas procedurës së shkurtuar, në këtë rast ngarkohet pala me shpenzimet e rrënimin.

XV. E DREJTA PËR ANKESË

Neni 57

Kundër çdo aktvendimi apo akti të nxjerrë në bazë të kësaj rregulloreje, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese organit kompetent në bazë të ligjit.

XVI. KOMPENSIMET DHE TAKSAT

Neni 58

Kompensimet dhe taksat bëhen sipas aktvendimeve dhe akteve tjera të nxjerra në bazë të kësaj rregulloreje dhe do të paguhen sipas tarifave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi dhe rregullativën tjetër të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës.

XIX. PËRGJEGJËSIA E PËRBASHKËT E PERSONAVE TË PËRFSHIRË NË NDËRTIM TË KUNDËRLIGJSHËM

Neni 59

Nëse në ndërtim kundërligjor është përfshirë më shumë se një person fizik apo juridik, përgjegjësinë në të gjitha pasojat juridike që rrjedhin nga kjo rregullore dhe nga rregullativa tjetër në fuqi, lidhur me këto ndërtime e mbajnë bashkërisht të gjithë personat e përfshirë në ndërtim.

XX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 60

Për çdo çështje të parregulluar me dispozitat e kësaj rregulloreje aplikohen ligjet e aplikueshme.

Neni 61

Të gjitha kërkesat e arritura para ditës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, për të cilat nuk është filluar procedura, si dhe ato për të cilat është duke u zhvilluar procedura e zgjedhjes së tyre do të zgjidhen në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje.

Neni 62

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Inspektime.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Neni 64

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve nr.119/10 dt. 27.05.2010.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa